

**I** FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:  
Informacion për pacientin

## NALIDIKSINE

Tabletë - 500mg  
(Acid nalidiksik)

**Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.**

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma me ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtëfletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

**Në këtë fletëudhëzues:**

- Çfarë është Nalidiksine dhe për çfarë përdoret
- Përpara se të merrni Nalidiksine
- Si ta merrni Nalidiksine
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Nalidiksine
- Informacion i mëtejshëm

### 1. ÇFARË ËSHTË NALIDIKSINE DHE PËRSE PËRDORËT

Acidi nalidiksik mendohet se e ushtron veprimin e tij duke ndërhyrë në replikimin e ADN-së bakterore, siç duket duke frenuar veprimtarinë e xhirazës (topoizomerazës) së ADN-së. Acidi nalidiksik vepron kundër baktereve gram – negative, si: *Escherichia coli*; llojeve të *Klebsiella*; llojeve të *Proteus*; llojeve të *Enterobacter*; llojeve të *Salmonella* dhe llojeve të *Shigella*. Ai zakonisht ushtron veprim baktericid. Shumica e mikrobeve të ndjeshme frenohen nga 16 mcg / mL ose edhe në përqendrim më të ulët. *Pseudomonas aeruginosa*, bakteret gram – pozitive dhe ato anaerobe, në përgjithësi nuk janë të ndjeshme ndaj acidit nalidiksik. Rezistenca bakterore mund të shfaqet shpejt, nganjëherë brenda pak ditësh nga fillimi i mjekimit. Rezistenca e kryqëzuar mund të shfaqet me acidin oksolinik dhe kinoksacinën. Veprimi antibakteror i acidit nalidiksik nuk ndikohet shumë nga ndryshimet e pH-it urinar. Ndërmjet nitrofurantoinës dhe acidit nalidiksik është vërtetuar antagonizëm *in vitro*.

Acidi nalidiksik përthithet shpejt dhe pothuajse plotësisht nga aparati tretës. Përqendrimet plazmatike prej 20 deri në 50 mcg për mL arrihen brenda 2 orësh pas marrjes nga goja të 1 g bari. Gjysmëjeta plazmatike është rreth 1 deri në 2.5 orë. Acidi nalidiksik metabolohet pjesërisht në acid hidroksinalidiksik, i cili ka veprim antibakteror të ngjashëm me acidin nalidiksik. Rreth 93% e acidit nalidiksik dhe 63% e acidit hidroksinalidiksik lidhen me proteinat plazmatike. Si acidi nalidiksik, ashtu edhe acidi hidroksinalidiksik metabolohen shpejt në glukuronide dhe rrjedhës të acidit dikarboksilik që janë joveprues;

vetëm metaboliti kryesor joveprues, acidi karboksinalidiksik zakonisht mund të zbulohet në urinë. Acidi nalidiksik dhe metabolitët e tij jashtëqiten shpejt përmes urinës; zakonisht e gjithë doza jashtëqitet brenda 24 orësh. Afërsisht 80 deri në 90% e barit të jashtëqitur përmes urinës është në trajtë metabolitësh joveprues. Gjurmët e acidit nalidiksik shfaqen në qumështin e gjirit dhe e kalojnë placentën. Rreth 4% e dozës së acidit nalidiksik jashtëqitet me feçet.

**Nalidiksine – 500 mg tabletë përdoret në:**

- Mjekim i infeksioneve akute e kronike, sidomos të atyre të traktit urinar, të shkaktuara nga mikroorganizmat gram – negative (përveç llojeve të ndryshme të *Pseudomonas*), të ndjeshme ndaj acidit nalidiksik;
- mund të përdoret edhe për mjekimin e rasteve të veçanta të infeksioneve gastrointestinale, të shkaktuara nga baktere gram – negative, të ndjeshme ndaj acidit nalidiksik (diarre bakterore).

### 2. PËRPARA SE TË MERRNI NALIDIKSINE Mos merrni Nalidiksine :

- Në qoftë se jeni i ndjeshëm (allergjik) ndaj Acidit nalidiksik ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të Nalidiksine .
- Mbindjeshmëri ndaj komponimeve të ngjashme me acidin nalidiksik.
- çrregullime të mëparshme konvulsive ose porfiri.

**Tregoni kujdes të veçantë me Nalidiksine**

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Nalidiksine.

- Acidi nalidiksik duhet përdorur me kujdes në të sëmuret që kanë një predispozicion të njohur alergjik.
- Të sëmuret që mjekohen me këtë bar duhet të mënjanojnë ekspozimin e tepër në diell.
- Acidi nalidiksik duhet përdorur me kujdes në sëmundjet e mëlçisë, sepse ai metabolohet kryesisht në këtë organ.
- Gjatë mjekimit për më shumë se 2 javë, është e nevojshme që të kryhen analizat periodike të gjakut, si edhe provat për funksionin e veshkave dhe të mëlçisë.
- Kujdes i veçantë duhet treguar gjatë periudhës së shtatzënisë, sidomos gjatë tremujorit të parë, si edhe gjatë ushqyerjes së fëmijëve me gjii.
- Të sëmuret duhen paralajmëruar që bari mund të japë përgjumje, prandaj ata duhet të tregohen të kujdesshëm kur drejtojnë automjetin ose kur punojnë me makineri.

**Marrja e barnave të tjera:**

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Nalidiksine. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Nalidiksine - 500 mg në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit. Është **veçanërisht e rëndësishme** që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:

- Varfarinë ;Acidi nalidiksik e rrit efektin e antikoagulesve që merren nga goja, psh.

varfarinës, kështu që doza e antikoagulesve duhet ulur.

- Nitrofurantoina dhe Acidi nalidiksik dhe janë antagonistë in vitro, kështu që nuk duhen përdorur së bashku.
- Nga përdorimi në të njëjtën kohë i acidit nalidiksik dhe melfalanit është konstatuar helmueshmëri serioze gastrointestinale.

**Shtatzania**

**Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut**

**përpara se të merrni këtë bar**

Këshillohet mënjanimi i përdorimit të Nalidiksine gjatë shtatzënisë. Nalidiksine nuk duhet të përdoret gjatë tremujorit të parë të periudhës së shtatzanisë vetem në qoftë se mjeku e sheh të nevojshme dhe matet faktori rrisik / benefit. Prandaj, gjithmonë konsultohuni me mjekun tuaj përpara se të përdorni Nalidiksine gjatë shtatzanisë.

**Ushqimi me gji**

Nalidiksine kalon në qumështin e gjirit dhe prandaj nuk duhet të përdoret gjatë ushqimit të foshnjës me gji.

**Drejtimi i makinës dhe përdorimi i makinerive**

Nalidiksine mund të shkaktojë përgjumje, çka mund t'i dëmtojë aftësitë e të sëmurit për të drejtuar automjetin ose për të punuar me makineri.

### 3. SI TA MERRNI NALIDIKSINE

Gjithmonë merreni Nalidiksine sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Nalidiksine janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Tabletat duhet të gëlltiten me të paktën gjysëm gotë ujë. **Tabletat e Nalidiksine disponohen në formdozën: 500 mg**

*Të rriturit, dozimi fillestar:* 1 g, 4 herë në ditë, për 2 javë. *Mjekimi afatgjatë:* 1 g, 2 herë në ditë, pas mjekimit fillestar.

*Fëmijët 3 muajsh – 2 vjeç, mjekimi fillestar:* 55 mg / kg peshë / ditë, në 4 doza të barabarta, të ndara. *Mjekimi afatgjatë:* 33 mg / kg peshë / ditë, në 4 doza të barabarta, të ndara, pas mjekimit fillestar. Megjithatë doza mund të ketë nevojë për tu rritur ose për tu ulur. Mjeku juaj do t'ju këshillojë në përputhje me rrethanat.

**Në qoftë se keni marrë më shumë Nalidiksine:**

Në qoftë se keni marrë më shumë Nalidiksine se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren. Nuk duhet të merret për një kohë të gjatë Nalidiksine sepse shfaqet vartësi ndaj ndaj këtij bari.

**Në qoftë se keni harruar të merrni Nalidiksine:**

Në qoftë se harroni një dozë (ose me shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).

Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

### 4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME TË NALIDIKSINE

Si të gjithë barnat e tjera, Nalidiksine mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Ndonjëherë ato janë serioze ndonjëherë jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre. Efektet e padëshirueshme më të shpeshta janë në:

- Acidi nalidiksik mund të japë efekte të padëshirueshme në sistemin nervor qendror (përgjumje, dobësi, dhembje koke, marrje mendsh, hipertension intrakranial);
- kur përdoren doza të larta mund të shfaqen edhe psikoza toksike dhe konvulsione të shkurtra);
- çrregullime gastrointestinale (dhembje abdominale, të përziera, të vjella, diarre);
- çrregullime alergjike (ekzantema, të kruiditura, urtikarie, angioedemë dhe në raste të rralla reaksione anafilaktike);
- reaksione hematologjike (trombocitopeni, leukopeni, eozinofili ose anemi hemolitike, nganjëherë të shoqëruara me pamjaftueshmëri të glukozë - 6 - fosfatdehidrogjenazës).
- Janë konstatuar edhe reaksione fotosensibilizimi, parestezi, acidozë metabolike, çrregullime të të parit, iktër kolestatik dhe kolestatë.

Në qoftëse ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftëse vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

### 5. SI TA RUANI NALIDIKSINE

Mbajeni larg fëmijëve. Mos e përdorni Nalidiksine pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim. Mos e ruani mbi 25°C Ruajeni në paketimin original për ta mbrojtur nga drita.


### 6. INFORMACON I MËTEJSHËM




**Çfarë përmban Nalidiksine**  
**Lënda vepruese** është: Acid nalidiksik  
Çdo tabletë përmban 500 mg Acid nalidiksik. Përbërësit e tjerë janë: Amidon, talk, gelatine, aerosil, stearat magnezë.

**Përmbajtja e paketimit**


Format e paketimit: kuti me 30 tableta.

**Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:**

 Sipas recetës së mjekut.

 Përmbajtja.  Kujdes.  Forma e tabletës.

**Mbajtësi i autorizimit për tregtim dhe prodhuesi:**

 **PROFARMA Sh.a.**  
Rruga "Myslym Keta"  
Tel. Fax: 00 355 4 23 62 800  
Tiranë - SHQIPËRI

**Ky fletëudhëzues u rishiku për herë të fundit në Mars 2011**

**PAY ATTENTION**, all the layers are visible.

If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.

 SPECIFICATION



CROPING AREA 12 x 19 cm